

KOMUNIKATË

Seanca XII e Bordit të ZRRE në 2025

Më 30.12.2025, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka mbajtur seancën e dymbëdhjetë (XII) për vitin 2025.

Gjatë kësaj seance Bordi ka shqyrtuar dhe miratuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për ndërmarrjen NQ Termokos sh.a dhe për ndërmarrjen NQ Gjakova sh.a për sezonin e ngrohjes 2025/2026. Është bërë edhe shqyrtimi dhe miratimi i tarifave të energjisë termike për konsumatorët fundorë të NQ Termokos sh.a dhe NQ Gjakova sh.a për sezonin e ngrohjes 2025/2026. Tarifat me matje për NQ Termokos sh.a janë zbritur për rreth 4% ndërsa për NQ Gjakova sh.a për rreth 5%.

Në këtë seancë, Bordi ka miratuar Aneks-Marrëveshjen ndërmjet Korporatës Energjetike të Kosovës KEK dhe Termokos sh.a për çmimin e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B.

Pjesë e shqyrtimit nga Bordi kanë qene edhe ankesat e konsumatorëve dhe çështje të tjera që lidhen me menaxhimin dhe funksionimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Të gjitha vendimet e Bordit të ZRRE-së do të publikohen në faqen elektronike të ZRRE-së www.ero-ks.org